

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Ferit Osmani, kryetar i kolegjit, gjyqtarët Hashim Çollaku dhe Biljana Rexhiq, anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Visar Gashi, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarit Zh.B., nga fshati ..., Komuna e Graçanicës, për shkak të veprës penale ndryshimi i njehsorit të shërbimeve nga neni 323 par 1 të KPK, duke vendosur sipas ankesës së të akuzuarit, të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-dega në Lipjan, P.nr.57/2016, të datës 30.06.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur me 05.10.2017, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e të akuzuarit Zh.B., kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-dega në Lipjan, P.nr.57/2016, të datës 30.06.2017, **vërtetohet**.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e ankimuar të Gjykatës Themelore në Prishtinë-dega në Lipjan, P.nr.57/2016, të datës 30.06.2017, është shpallur fajtor i akuzuari Zh.B., për shkak të veprës penale ndryshimi i njehsorit të shërbimeve nga neni 323 par 1 të KPK, dhe i është shqiptuar dënimi me kusht, duke i vërtetuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet po që se i akuzuari në afatin e verifikimit prej 1 (një) viti, nuk kryen ndonjë vepër të re penale, si dhe dënimin me gjobë në shumën prej 400 (katërqind) €, të cilin dënim është obliguar që ta paguajë në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në të kundërtën dënimi i shqiptuar me gjobë, në kuptim të nenit 46 par 3 të KPK, do të zëvendësohet në dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 20 (njëzetë) ditëve, duke llogaritur për çdo ditë të kaluar në burg nga 20 (njëzetë) €.

Është detyruar i akuzuari Zh.B., që të dëmtuarës KEDS, t'ia kompensojë dëmin e shkaktuar në shumën prej 1.843,80 €, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Është obliguar i akuzuari që të paguajë të gjitha shpenzimet e procedurës penale sado që të jenë ato sipas llogarisë së bërë në arkë të gjykatës, si dhe paushallin gjyqësor në shumën prej 30 (tridhjetë) €, të gjitha këto në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Kundër këtij aktgjykimi, në afat ligjor ka ushtruar ankesë i akuzuari Zh.B., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, vendimit për dënimin, vendimit për

kërkesën pasurore-juridike, si dhe vendimit mbi paushallin gjyqësor, duke propozuar që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet, dhe i akuzuari të lirohet nga akuza, ose i njëjti të anulohet dhe çështja penale ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe vendosje, por në Gjykatën Themelore në Prishtinë-dega në Graçanicë.

Prokuroria e Apelit në Prishtinë me shkresën PPA/II.nr.983/2017, të datës 18.09.2017, duke u sqaruar përkitazi me ankesën e të akuzuarit Zh.B., ka propozuar që e njëjta të refuzohet si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit në kuptim të nenit 394 të KPPK, duke vlerësuar pretendimet ankimore nga ankesa e të akuzuarit, propozimit me shkrim të Prokurorisë së Apelit në Prishtinë, si dhe shkresave tjera të lëndës ka gjetur se:

Ankesa e të akuzuarit Zh.B., nuk është e bazuar.

Sipas ankesës së të akuzuarit, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, ankimohet për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, të cilat konsistojnë në kuptim të nenit 384 par 1 pika 1.12 lidhur me nenin 370 të KPPK, sepse dispozitivi i aktgjykimit të ankimuar nuk i përmban të gjitha shënime e nevojshme sikurse parashihen në dispozitën ligjore nga neni 365 të KPPK, duke mos përfshirë se cila është vepra penale, duke mos theksuar se cili është njehsori i energjisë elektrike që është manipuluar. Të gjitha këto mangësi kanë kushtëzuar që aktgjykimi mos të përpilohet në formën e shkruar sikurse parashihet dispozita ligjore përkatëse, e gjithashtu i njëjti përfshihet edhe me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par 1 pika 1.6 të KPPK, sepse të njëjtin e ka nxjerrë gjykata e cila nuk ka patur kompetencë territoriale për të gjykuar. Gjithashtu, në ankesë të akuzuarit theksohet se i njëjti e ka kundërshtuar në fillim të shqyrtimit gjyqësor përkatësisht në seancën fillestare, duke theksuar se jeton në fshatin ..., kurse kompetente për zgjedhjen e kësaj çështje penale është Gjykata Themelore në Prishtinë-dega në Graçanicë, duke theksuar se gjuhë amtare e ka gjuhën serbe, dhe se nuk e njih gjuhën shqipe. Të gjitha kontrollet janë kryer nga pjesëtarët e nacionalitetit shqiptar, procesverbalet janë hartuar në gjuhën shqipe, të cilën gjuhë unë nuk e kuptoj, andaj, si rezultat i kësaj, jam i mendimit se aktgjykimi i ankimuar përfshihet me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, dhe si i tillë është i pa pranueshëm.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, e ka shqyrtuar dhe vlerësuar aktgjykimin e ankimuar, sipas ankesës së ushtruar, si dhe shkresat e tjera të lëndës, në kuptim të nenit 394 të KPPK, për të cilat shkelje përkujdeset edhe sipas detyrës zyrtare, dhe ka ardhur në përfundim se dispozitivi i aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, është i qartë, i kuptueshëm dhe në harmoni me vetveten, dhe me arsyetimin e të njëjtit, sepse përmban arsyet lidhur me faktet vendimtare, të cilat karakterizojnë veprën penale ndryshimi i njehsorit të shërbimeve nga neni 323 par 1 të KPK, sepse gjykata e shkallës së parë aktgjykimin e ka përpiluar sipas dispozitave ligjore, duke përmbushur formën e cila kërkohet me ligj. Nga aktgjykimi i ankimuar rezulton se i njëjti ka pjesën hyrëse me të gjitha shënimet e kërkuara, veprën penale e cila i vihet në barrë të akuzuarit, përshkrimi i së njëjtës është bërë në formën e duhur, duke bërë përshkrimin faktik të kryerjes së veprës penale, si dhe elementet qenësore të së njëjtës, se gjykata e shkallës së parë ka gjykuar çështjen në kuadër të kompetencës lëndore sikurse kërkohet në nenin 384 par 1 pika 1.6 të KPPK. Gjithashtu, nga shkresat e lëndës rezulton se në mënyrë të drejtë janë zbatuar

dispozitat ligjore nga neni 365 par 1 pika 1.1 të KPPK, andaj, si rezultat i veprimit të gjykatës së shkallës së parë në kuadër të dispozitave përkatëse ligjore, kolegji i kësaj gjykate vie në përfundim se aktgjykimi është i pranueshëm për kolegjin e kësaj gjykate, sepse përmban arsye të mjaftueshme për çdo pikë të aktgjykimit, dhe se gjykata e shkallës së parë ka paraqitur arsyet se cila fakte dhe për çfarë arsye konsiderohen të vërtetuara, se ka paraqitur saktësinë e provave të cilat kanë qenë vendimtare dhe në të cilat është bazuar me rastin e zgjedhjes së çështjes juridike, për vërtetimin e ekzistimit të veprës penale dhe përgjegjësisë penale të akuzuarit, andaj, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë si i tillë është i pranueshëm për kolegjin e kësaj gjykate.

Sipas ankesës së të akuzuarit, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, ankimohet për shkak të shkeljes së ligjit penal, duke theksuar se i akuzuari nuk është manipulues i bllombave të cilat janë objekt shqyrtimi në këtë çështje penale, mirëpo kolegji i kësaj gjykate në kuptim të neni 385 të KPPK, e ka shqyrtuar dhe vlerësuar aktgjykimin e ankimuar, ankesën e ushtruar, si dhe shkresat e tjera të lëndës, edhe sipas shkeljeve të tjera të cilat janë të përfshira me shkeljet e ligjit penal, dhe ka ardhur në përfundim se aktgjykimi i ankimuar nuk përfshihet me shkeljet e ligjit penal, se vepra penale për të cilën është akuzuar i akuzuari parashihet me ligjin e aplikueshëm, se nuk ekzistojnë rrethana që përjashtojnë të akuzuarin nga përgjegjësia penale dhe ndjekja penale, se gjykata në mënyrë të drejtë ka zbatuar ligjin i cili ka qenë aplikueshëm në kohën e kryerjes së veprës penale, se gjykata ka vepruar në kuadër të kompetencës ligjore, andaj, aktgjykimi i ankimuar është i pranueshëm për kolegjin e kësaj gjykate.

Sipas ankesës së të akuzuarit, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë ankimohet për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, duke theksuar se gjykata e shkallës së parë nuk e ka vërtetuar se cilin njehsor përkatësisht cilën bllombë dhe në çfarë mënyre e ka dëmtuar i akuzuari. I njëjti thekson se punëtorët e të dëmtuarës KEDS, e kanë ndërruar njehsorin me dt.07.08.2015, duke hartuar procesverbal, mirëpo me dt.24.08.2015, pas 17 ditëve, e kanë ndërruar njehsorin dhe kanë hartuar procesverbalin, nga i cili më kanë ngarkuar me dëmin në shumën prej 1.843 €, nga e cila rezulton se nuk dihet se cilat manipulime janë kryer në cilin njehsor, sepse janë përpiluar dy procesverbale. Jam befasuar se si është e mundur që të kem një ngarkesë prej 1.843 €, duke patur parasysh se nuk kam ndonjë pajisje e cila bënë shpenzimin e energjisë elektrike në këtë masë, andaj, si të tillë aktgjykimin e kontestojë.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, e ka shqyrtuar dhe vlerësuar aktgjykimin e ankimuar, ankesën e ushtruar, si dhe shkresat e tjera të lëndës, dhe ka ardhur në përfundim se nga ana e gjykatës së shkallës së parë, gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, e cila vërtetohet nga deklaratat e dëshmitarëve-ekspertëve, Turkmen Spahiu, përndryshe punëtor i Qendrës së Kalibrimit, i cili ka theksuar se në njehsorin me nr.675295, është kërkuar të bëhet kontrollimi detal, në të cilin pas kontrollit është konstatuar se bllombat i ka patur të manipuluar, të hapura dhe prapë të mbyllura, nga jashtë nuk ka patur dëmtime. Në njehsor është konstatuar se numëruesi i njehsorit është manipuluar, ka patur gërvishje në numëror, shifra e 3 numër 1,2, shifra e 4 numër 5,6, shifra 5 numër 6,7 në T1, i cili është fotografuar me bllombën distributive me nr N1082157m që ka qenë si dëshmi për punën e mëtejme. Të gjitha parregullsitë kanë qenë të konstatuara në procesverbal. Gjithashtu edhe nga deklarata e dëshmitarit Ilir Kelmendi, punëtor në Qendrën e Klibrimit të KEDS, i njëjti thekson se për detyrë ka të bëjë

verifikimin e njehsorëve për ndonjë keqpërdorim eventual gjatë ndërrimit. Përndryshe, të njëjtit vijnë pa emra dhe pa shifra por vetëm me të dhelna teknike, kurse komisioni prej tre anëtarëve e bënë verifikimin e tyre, ashtu që në njehsorin nr.6752295, janë konstatuar manipulimet e lart theksuara, të cilët janë përcjellë për punë të mëtejme. Nga këto deklarata është vërtetuar se nga manipulimet në blloba, është konstatuar se ndërmarrjes KEDS, i është shkaktuar dëmi prej 1.843,80 €, e cila vërtetohet në bazë të faturës DFE15HP10943, të dt.24.08.2015, kurse deklarata e të akuzuarit ka patur për qëllim të shmangies së fajësisë për veprën penale e cila i vihet në barrë, andaj, kolegji i kësaj gjykate pasi ka vlerësuar aktgjykimin sipas ankesës dhe të gjitha shkresat e lëndës, ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit janë formuluar elementet qenësore të veprës penale ndryshimi i njehsorit të shërbimeve nga neni 323 par 1 të KPK, dhe si i tillë aktgjykimi nuk përfshihet me shkeljet sa i përket vërtetimit të gjendjes faktike, andaj, është i pranueshëm për kolegjin e kësaj gjykate.

Sipas ankesë së të akuzuarit, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, ankimohet për shkak të vendimit për sanksionin penal, kërkesën pasurore juridike, duke theksuar se nuk është e vërtetu që nga ana e të akuzuarit është bërë dëmtimi i njehsorit të shërbimeve, se nuk i kam manipuluar bllobat, se jam i moshës 80 vjeçare, se asnjëherë nuk kam rënë në kundërshtim me ligjin, se pas këtij rasti mu ka dëmtuar gjendja shëndetësore, andaj, kërkon që pas vlerësimit të ankesës , të ndryshohet aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë dhe i akuzuari të lirohet nga fajësia, ose i njëjti të anulohet dhe çështja penale ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe vendosje.

Kolegji i kësaj gjykate e ka vlerësuar aktgjykimin e ankimuar, dhe ka ardhur në përfundim se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike, se aktgjykimi i ankimuar nuk përfshihet me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, si dhe shkeljet e ligjit penal, andaj, duke vlerësuar aktgjykimin e ankimuar, kolegji vie në përfundim se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë me rastin e marrjes se vendimit për dënimin, caktimit të llojit dhe lartësisë së tij, në kuptim të nenit 73 të KPK, sikurse janë rrethanat lehtësuese, se i akuzuari është i moshës së shtyrë, sjelljen e tij të mëparshme, motivet për kryerjen e veprës penale, ka vlerësuar edhe rrethanat rënduese, sidomos intensitetin e rrezikimit apo dëmtimit të vlerës së mbrojtur, si dhe rrethanat nën të cilat është kryer vepra penale, e duke mos gjetur ndonjë rrethanë posaçërisht lehtësuese, kolegji i kësaj gjykate, vlerëson se dënimi i shqiptuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë, është proporcional me peshën e veprës penale të kryer, dhe se është i bindur se me dënimin e shqiptuar do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij i paraparë me nenin 41 të KPK, që të parandaloj kryerësin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëj rehabilitimin e tij, të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëj kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale, dhe të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Gjithashtu, gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar dispozitat ligjore, kur ka vendosur për ankesën përkitazi me kërkesën pasurore juridike, dhe ka ardhur në përfundim se e njëjta është shqiptuar në kuadër të dispozitave përkatëse ligjore, pasi që ka konstatuar se në këtë çështje penale të dëmtuarës KEDS, i është shkaktuar dëmi sikurse në dispozitiv të

aktgjykimit, si dhe drejtë ka vendosur kur të akuzuarin pasi që e ka shpallur faktor e ka obliguar edhe me pagesën e paushallit gjyqësor.

Nga sa u tha më lartë e në pajtim me dispozitën e nenit 401 të KPPK, u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PA1. nr.967/2017 të datës 05.10.2017

Zyrtari Ligjor
Visar Gashi

Anëtarët e kolegjit
Hashim Çollaku

Kryetari i kolegjit
Ferit Osmani

Biljana Rexhiq